

"O ju që besoni kijeni frikë Allahun
dhe le të shohë çdo njeri
çfarë ka përgatitur për të nesërmen!"



Ligjëratë e mbajtur në Radio.Selefi.org më 11/03/2014

nga Shejkh 'Abdul-'Aziiz Ibën Jahja el-Bura'ij



“O ju që besoni kjeni frikë Allahun dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përçatitur për të nesërmen!”

Ligjëratë e mbajtur nga Shejkh 'Abdul-'Aziqz Dben Jahja el-Bura'ij në Radio,Selefi.org



“O ju që besoni kijeni frikë Allahun dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përgatitur për të nesërmen!”
Ligjëratë e mbajtur nga Shejkh ‘Abdul-‘Aziqz Dben Jahja el-Bura’ij në Radio.Selefi.org



“O JU QË BESONI KIJENI FRIKË ALLAHUN DHE LE TË SHOHË ÇDO NJERI ÇFARË KA PËRGATITUR PËR TË NESËRMEN!”

*Ligjëratë e mbajtur në Radio.Selefi.org më 11/03/2014
nga Shejkh ‘Abdul-‘Aziqz Dben Jahja el-Bura’ij*

Të gjitha lavdet janë për Allahun, Zotin e gjithësisë. Unë dëshmoj se s’ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut të vetëm e të pashok, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij, Allahu i dhëntë lavdërime dhe bekime atij dhe Familjes së tij.

E më pas:

Thotë Allahu - Tebarake ue Te’ala - në Librin e Tij fisnik:

يٰۤاَيُّهَا الَّذِيْنَ ءَامَنُوْا اتَّقُوا اللّٰهَ وَلْتَنْظُرْ نَفْسٌ مَّا قَدَّمَتْ لِغَدٍ وَاتَّقُوا اللّٰهَ ۗ اِنَّ اللّٰهَ خَبِيْرٌۢ بِمَا تَعْمَلُوْنَ
وَلَا تَكُوْنُوْا كَالَّذِيْنَ نَسُوا اللّٰهَ فَاَنْسَاهُمْ اَنْفُسَهُمْ اُوْلٰئِكَ هُمُ الْفٰسِقُوْنَ ﴿١٨﴾

“O ju që besoni, kijeni frikë Allahun dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përgatitur për të nesërmen. Dhe kijeni frikë Allahun, se me të vërtetë Allahu është i Mirëinformuar për ato që bëni ju. Dhe mos u bëni si ata të cilët e harruan Allahun dhe Allahu i bëri ata t’i harronin vetet e tyre; pikërisht ata janë të pabindurit.”¹

¹ El-Hashr, 18-19.

“O ju që besoni kijeni frikë Allahun dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përgatitur për të nesërmen!”
Ligjëratë e mbajtur nga Shejkh ‘Abdul-‘Aziiz Dbën Jahja el-Bura’ij në Radio,Selefi.org



Ky ajet fisnik është një këshillë prej këshillave të Kur`anit fisnik, me të cilin na këshillon Allahu - ‘Azze ue Xhel-le -.

Allahu - ‘Azze ue Xhel-le - thotë:

يَتَأْتِيهَا النَّاسُ قَدْ جَاءَتْكُمْ مَوْعِظَةٌ مِّن رَّبِّكُمْ

“O njerëz, ju ka ardhur këshillë nga Zoti juaj.”²

Pra, kjo është këshillë. Dhe Allahu e ka bërë të gjithë Kur`anin me këshilla, me të cilat Ai na këshillon. Dhe qëllimi me këto këshilla është që ne të përgatitemi për Takimin me Allahun - ‘Azze ue Xhel-le -. Prandaj, Ai ka thënë:

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَلْتَنْظُرْ نَفْسٌ مَّا قَدَّمَتْ لِغَدٍ

“O ju që besoni, kijeni frikë Allahun dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përgatitur për të nesërmen.”³

Pra, cila është ajo gjë me të cilën duhet të përgatiteni për Takimin me Allahun - ‘Azze ue Xhel-le -. Dhe me “të nesërmen” është për qëllim Dita e Kijametit, e nuk është për qëllim këtu dita e nesërme mbas ditës që jemi sot, porse është për qëllim Dita e Kijametit.

Allahu - ‘Azze ue Xhel-le - na ka këshilluar me këtë këshillë të bekuar dhe na thirri me emrin e imanit, dhe tha: “O ju që besoni...” Andaj kush

² Junus, 57.

³ El-Hashr, 18.

“O ju që besoni kijeni frikë Allahun dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përgatitur për të nesërmen!”
Ligjëratë e mbajtur nga Shejkh ‘Abdul-‘Aziq Obën Jahja el-Bura’ij në Radio,Selefi.org



është besimtar, Allahu po e thërret atë, e kush ia kthen shpinën kësaj thirrjeje, në të vërtetë ai e ka lëkundur veten e tij nga imani, në varësi të përmasës së braktisjes së kësaj thirrjeje.

Për këtë thirrje ka folur Allahu - *‘Azze ue Xhel-le* - dhe atë e ka dëgjuar Xhibrili dhe për të u hapën të shtatë qiejt, dhe ai ia dha Pejgamberit - *sal-lAllahu ‘alejhi ue ‘ala Aalihi ue sel-lem* -. Kurse i Dërguari - *sal-lAllahu ‘alejhi ue ‘ala Aalihi ue sel-lem* - ua dha Sahabëve të tij. Dhe atë e morën dijetarët dhe nxënësit e dijes, të cilët janë marrë me të kohë mbas kohe, deri në kohën tonë sot. Prandaj, ne duhet patjetër që ta dimë këtë thirrje madhështore dhe e kemi detyrë që të hapim për të veshët tanë dhe të hapim për të zemrat tona, dhe të mahnitemi që Allahu po na thërret për një çështje madhështore. Nëse dikush nga shokët e tu do të të thërriste në emër, pastaj ti nuk kthehesh nga ai, kjo do të ishte turp për ty. E si është çështja atëherë kur thirrësi është Zoti i gjithësisë? Dhe thirrja nderohet me nderin e thirrësit. Pra, Allahu na thërret për të na nderuar duke na thirrur me emrin e imanit.

“O ju që besoni, kijeni frikë Allahun...” domethënë, le të jetë rezultati i frikës suaj përgatitja, përgjigja juaj për t’u përgatitur për Takimin me Allahun - *‘Azze ue Xhel-le* -.

“O ju që besoni, kijeni frikë Allahun dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përgatitur për të nesërmen.” Dhe prej frikës që kemi nga Allahu - *‘Azze ue Xhel-le* - është që të sjellim ndërmend vazhdimisht çfarë kemi përgatitur për Takimin me Allahun - *Tebarake ue Te’ala* -, sepse shumë prej njerëzve janë të shkujdesur, kurse i suksesshëm është ai të cilit i jep sukses Allahu dhe kush përgatitet për Takimin me Allahun.



Sot je i gjallë, kurse nesër je i vdekur. Ti nuk e di kur të vjen vdekja, nuk e di kur të vjen fundi. Vdes i riu, vdes i moshuari, vdes vajza e re, vdes e moshuara. Kurdo që të vijë vdekja, ajo do të vijë për të gjithë. Prandaj ji i përçatitur për Takimin me Allahun. Ti nuk e di kur do të vdesësh. Ti nuk e di kur do të vdesësh. Të mos tregohemi të shkujdesur ngaqë ndihemi të fuqishëm fizikisht. Ka prej njerëzve që tregohen të shkujdesur, ngaqë janë të preokupuar me jetën rinore, apo me fuqinë e trupit të tyre, apo preokupohen me lojra e dëfrime, apo preokupohen me tregëti, apo preokupohen me postin apo me pozitën që kanë në shoqëri apo me gjëra të tjera si këto. Pra, ata preokupohen dhe kështu largohen nga bindja ndaj Allahut - *‘Azze ue Xhel-le* -.

Pra, Allahu - *‘Azze ue Xhel-le* - na tërheq vëmendjen dhe na urdhëron që ta kemi në mendje qëndrimin para Tij. Ne do të qëndrojmë përpara Allahut këmbë-zbathur e të zhveshur, do të ikin nga ne ata që i kishim patur të afërt dhe ata që i kishim të largët, do të ikin nga ne qofshin shumë a pak, e s’do të kemi asgjë tjetër në atë Ditë. Do të ringjallen njerëzit këmbë-zbathur e të zhveshur, nuk do të kenë as mbretëri e as udhëheqje. Do të ikin të gjithë e s’do të mbetet askush tjetër pos veprës tënde: nëse është e mirë do të gjesh mirë, e nëse është e keqe do të gjesh keq. Nuk do të zbresësh në varrin tënd me sevapet e dikujt tjetër dhe as me gjynahet e dikujt tjetër. Çdonjëri prej nesh ka për të zbritur në varrin e tij vetëm me sevapet e tij dhe me gjynahet e tij. Ka thënë Pejgamberi - *sal-lAllahu ‘alejhi ue ‘ala Aalihi ue sel-lem* -:

يتبع الميت ثلاثة فيرجع اثنان ويبقى واحد يتبعه أهله وماله وعمله فيرجع أهله وماله
ويبقى عمله.

“O ju që besoni kijeni frikë Allahun dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përçatitur për të nesërmen!”
Ligjëratë e mbajtur nga Shejkh ‘Abdul-‘Aziiz Dbën Jahja el-Bura’ij në Radio.Selefi.org



“E shoqërojnë të vdekurin tre gjëra: kthehen mbrapa dy dhe mbetet me të vetëm një; e shoqërojnë atë familja e tij, pasuria e tij dhe vepra e tij; kthehet mbrapa familja dhe pasuria e tij dhe mbetet me të vepra e tij.”⁴

Kështu do të jetë gjendja jonë - Allahu të bekoftë -, kështu që çdo Musliman duhet të ketë gjithmonë në mendje veten e tij dhe qëndrimin e tij para Allahut - ‘Azze ue Xhel-le -.

“O ju që besoni, frikësojuni Allahut”, domethënë veproni me bindje ndaj Allahut dhe braktiseni mosbindjen ndaj Allahut. Veproni me bindje ndaj Allahut në përgjithësi dhe braktiseni mosbindjen ndaj Allahut në përgjithësi. Ka thënë Allahu - ‘Azze ue Xhel-le -:

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا أَدْخُلُوا فِي السَّلْمِ كَافَّةً

“O ju që besoni! Hyni në Islam tërësisht...”⁵

Kanë thënë dijetarët (për tefsirin e ajetit): domethënë merreni Islamin me të gjitha aspektet e tij. Pra, Ai na ka urdhëruar që ta marrim Islamin me të gjitha aspektet e tij; kurse me frikë ndaj Allahut kihet për qëllim që t’i frikësohemi Allahut duke vepruar të gjitha veprat që janë bindje ndaj Allahut dhe t’i braktisim të gjitha veprat që janë mosbindje ndaj Allahut dhe duhet që vendosmëria për këtë të jetë shumë e madhe, kurse dhënësi i suksesit është Allahu, dhënësi i suksesit është Allahu - Subhanehu ue Te’ala -.

Dhe Allahu - ‘Azze ue Xhel-le - thotë:

⁴ Transmetuar nga Bukhari në er-Rakaik (nr.6149), Muslimi në ez-Zuhd uer-Rraka`ik (nr.2960), Sunen et-Tirmidhi, ez-Zuhd (nr.2379), Sunen en-Nesa`ij, el-Xhena`iz (nr.1937).

⁵ El-Bekarah, 208.

“O ju që besoni kijeni frikë Allahun dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përgatitur për të nesërmen!”
Liqjërati e mbajtur nga Shejkh ‘Abdul-‘Aziqz Dbën Jahja el-Bura’ij në Radio,Selefi.org



يَتَأَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تَقَاتِهِ ؕ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُمْ مُسْلِمُونَ ﴿١٢﴾

“O ju që besoni, frikësojuni Allahut me një frikë të vërtetë dhe mos vdisni vetëm se duke qënë muslimanë.”⁶

E nëse vepron me ajetin e parë, pra që ta marrësh Islamin me të gjitha aspektet e tij, që është ajeti: “O ju që besoni! Hyni në Islam tërësisht...”, dhe nëse punon me këtë ajet: “O ju që besoni, frikësojuni Allahut me një frikë të vërtetë dhe mos vdisni vetëm se duke qënë muslimanë.”, tubohet bashkë i tërë kuptimi (i të dy ajeteve), dhe ai kuptim është: që ta marrësh Islamin me të gjitha aspektet e tij dhe të vazhdosh kështu natë e ditë, që nëse të vjen vdekja në çdo moment, ti je i përgatitur për Takimin me Allahun - *Xhel-le ue ‘Alaa -*.

Prandaj, Pejgamberi - *sal-lAllahu ‘alejhi ue ‘ala Aalihi ue sel-lem -* e përsëriste gjithmonë në shumë prej hytbeve e tij: “O ju që besoni, frikësojuni Allahut me një frikë të vërtetë dhe mos vdisni vetëm se duke qënë muslimanë.” Pra, ai i këshillonte njerëzit me këtë ajet në hytbet e tij, në mënyrë që njerëzit ta kishin vazhdimisht në mendje, për shkak të rëndësisë së tij dhe për nevojën që njerëzit kanë për të, që ta dinin kuptimin e tij dhe që të veprojnë me atë që kërkon ai. Kështu, Allahu - *‘Azze ue Xhel-le -* thotë: “O ju që besoni, kijeni frikë Allahun dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përgatitur për të nesërmen.” Çfarë kemi përgatitur për të nesërmen? Që njeriu të shohë se çfarë ka përgatitur për të nesërmen, që t’i bëjë llogarinë vetes; si je me namazin me xhemat? A i fal të pesta namazet? Ai fal ato me xhemat? Pejgamberi - *sal-lAllahu ‘alejhi ue ‘ala Aalihi ue sel-lem -* thotë:

أول ما يعرض من عمل العبد صلاته: إن صلحت صلح سائر عمله ، و إن فسدت فسدت سائر عمله.

⁶ Aali-Imran, 102.

“O ju që besoni kijeni frikë Allahun dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përgatitur për të nesërmen!”
Ligjëratë e mbajtur nga Shejkh ‘Abdul-‘Aziqz Dëbn Jahja el-Burá’ij në Radio,Selefi.org



“E para që do paraqitet nga veprat e robit është namazi i tij; nëse ai është në rregull, do të jenë në rregull veprat e tjera të tij; e nëse ai nuk është në rregull, nuk do të jenë në rregull edhe veprat e tjera të tij.”⁷

Për këtë arsye, secili prej nesh le të shikojë veten e tij për sa i përket namazit. Si jemi ne me namazin? Si u përgatite për kryerjen e namazit? Po gjatë faljes së namazit si je? A shpejton në namazin tënd? A e fal namazin me frikë-respekt ndaj Allahut? A e fal namazin me avash dhe i bën mirë rukutë, sexhdet e kështu me radhë? Si je ti me faljen e suneteve, me synetet e sabahut, me synetet e drekës para dhe mbrapa farzit, me synetet e akshamit dhe të jacisë? Si je ti me namazin e duhasë, si me namazin e vitrit? Si je ti me synetet e tjera dhe namazet e tjera, siç janë dy rekatet për xhaminë dhe dy rekatet mbas marrjes së abdesit? Si je ti me këto namaze, si je ti me këto vepra? Bëji llogarinë vetes tënde dhe shiko ku je dhe çfarë ke përgatitur për Takimin me Allahun - ‘Azze ue Xhel-le - për sa i përket namazit tënd.

Po kështu - Allahu të bekoftë -, si je ti përpara kësaj me çështjen e Teuhidit? A e veçon ti Allahun me Teuhidin që meriton Ai, duke mos iu lutur askujt tjetër pos Allahut, duke mos therur kurban për askënd tjetër pos Allahut, duke mos u zotuar në askënd tjetër pos Allahut, duke mos iu mbështetur askujt tjetër pos Allahut dhe të mos shpresosh tek askush tjetër por Allahut? Si je ti? Çfarë ke bërë e çfarë ke punuar? Po! Disa njerëz ndoshta janë të kujdesshëm për namazin, mirëpo ata kanë probleme në Teuhid. Ndoshta shikon se ai i lutet [fjalë e paqartë], i lutet Bedeviut ose i lutet të Dërguarit të Allahut - *sal-lAllahu ‘alejhi ue ‘ala Aalihi ue sel-lem* - ose

u lutet dhe u beson të tjerëve, qofshin prej të gjallëve apo prej të vdekurve. Kurse Allahu - *Subhanehu ue Te’ala* - thotë:

⁷ Transmetuar nga Ebu Davudi (nr.864), Tirmidhiu (nr.413), Nesaiu (nr.465) dhe Ibën Maxhe (nr.1425).

“O ju që besoni kijeni frikë Allahun dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përçatitur për të nesërmen!”
Ligjëratë e mbajtur nga Shejkh 'Abdul-'Aziiz Dbën Jahja el-Bura'ij në Radio.Selefi.org



فَلَا تَدْعُوا مَعَ اللَّهِ أَحَدًا ﴿١٨﴾

“Andaj mos iu lut askujt tjetër përkrah Allahut.”⁸

Dhe Ai ka thënë:

وَإِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ أُجِيبُ دَعْوَةَ الدَّاعِ إِذَا دَعَانِ ﴿١٨﴾

“Dhe kur robërit e Mi të pyesin për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes së atij që më lutet.”⁹

Dhe Ai ka thënë:

وَقَالَ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ إِنَّ الَّذِينَ يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ عِبَادَتِي سَيَدْخُلُونَ جَهَنَّمَ

دَاخِرِينَ ﴿١٩﴾

“Dhe ka thënë Zoti juaj: lutmuni vetëm Mua, Unë u përgjigjem juve. Ata të cilët tregohen mendjemëdhenj dhe nuk më adhurojnë vetëm Mua, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar.”¹⁰

Dhe Ai ka thënë:

قُلْ ادْعُوا الَّذِينَ زَعَمْتُمْ مِنْ دُونِهِ فَلَا يَمْلِكُونَ كَشْفَ الضُّرِّ عَنْكُمْ وَلَا تَحْوِيلًا ﴿٢٠﴾

“Thuaj: thirrini ata të cilët ju i adhuroni në vend të Allahut, porse ata nuk mund ta largojnë dëmin nga ju dhe as t’ua hedhin atë të tjerëve.”¹¹

⁸ El-Xhinn, 18.

⁹ El-Bekarah, 186.

¹⁰ El-Gafir, 60.

¹¹ El-Israa`, 56.

“O ju që besoni kijeni frikë Allahun dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përçatitur për të nesërmen!”
Ligjëratë e mbajtur nga Shejkh ‘Abdul-‘Aziqz Dben Jahja el-Bura’ij në Radio.Selefi.org



Pra, prej përgatitjes për Takimin me Allahun - ‘Azze ue Xhel-le - është që të jemi në rregull me Teuhidin dhe që ta kemi gjithmonë në mendje Madhështinë e Allahut, ta kemi gjithmonë në mendje që Allahu - ‘Azze ue Xhel-le - është afër nesh (me Dijen dhe Fuqinë e Tij) dhe Ai na shikon. Prandaj, njeriu s’duhet të jetë i shkujdesur ndaj Zotit të Tij. Dije se Allahu - Subhanehu ue Te’ala - na shikon... [fjalë të paqarta] ...prandaj qëndro larg mosbindjes ndaj Tij dhe.... [fjalë të paqarta] ...që Ai mos të dëgjojë nga ty ndonjë të keqe. Dhe le ta dijë Allahu që t’i ke vetëm qëllime të mira, kështu do të jesh në Kënaqësinë e Allahut - ‘Azze ue Xhel-le -.

Ne jemi të dobët e të varfër, kurse Allahu është i Plotëfuqishëm dhe Hakmarrës. Nëse Allahu do të na dënonte për gjynahet tona, Ai do të na kishte shkatërruar. Ka thënë Allahu - ‘Azze ue Xhel-le -:

وَلَوْ يُؤَاخِذُ اللَّهُ النَّاسَ بِظُلْمِهِمْ مَا تَرَكَ عَلَيْهَا مِنْ دَابَّةٍ وَلَكِنْ يُؤَخِّرُهُمْ إِلَىٰ أَجَلٍ مُّسَمًّىٰ ۖ فَإِذَا جَاءَ أَجْلُهُمْ لَا يَسْتَفْخِرُونَ سَاعَةً ۖ وَلَا يَسْتَقْدِمُونَ ﴿٦١﴾

“Sikur Allahu t’i dënonte njerëzit për shkak të zullumeve të tyre, nuk do të linte asgjë të gjallë në Tokë. Por Ai i lë ata deri në një afat të caktuar dhe, kur atyre u vjen afati, ata nuk mund ta shtyjnë atë e as ta shpejtojnë, qoftë edhe për një çast.”¹²

Po kështu – Allahu të bekoftë –, nëse Allahu ta ka bërë të lehtë fitimin e pasurisë, si je ti me pasurinë tënde? A e nxjerr zekatin e saj?

Po kështu, si je ti me agjërimin e Ramadanit? A je në rregull me agjërimin dhe a e kryen atë ashtu siç duhet? A e bën Ramadanin muaj të ibadetit? A i agjëron ditët nafile?

¹² En-Nahl, 61.

“O ju që besoni kijeni frikë Allahun dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përgatitur për të nesërmen!”
Liqjërati e mbajtur nga Shejkh 'Abdul-'Aziiz Dbën Jahja el-Bura'ij në Radio,Selefi.org



Po kështu – Allahu të bekoftë –, a e ke bërë haxhin e Islamit apo nuk e ke bërë?

Kontrolloje veten tënde në shtyllat e Islamit, ku je ti me shtyllat e Islamit? Kontrollloje veten tënde në të gjitha çështjet e tua dhe në të gjitha problemet e tua.

“Dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përgatitur për të nesërmen.”
Çfarë ke përgatitur prej recitimit të Kur`anit? Sa lexon në ditë nga Libri i Allahut - *'Azze ue Xhel-le -!* Ndoshta disa njerëzve u kalon tërë viti pa e lexuar të gjithë Kur`anin, dhe kjo është prej shkujdesjes – Allahu na ruajt -. E nëse Allahu ta bën të lehtë – qoftë edhe për një orë në ditë – lexoje Librin e Allahut, dëgjoje me përqëndrim Kur`anin dhe bëji dhikër Allahut - *'Azze ue Xhel-le -* dhe medito në Librin e Allahut - *'Azze ue Xhel-le -*, dhe ti për çdo shkronjë që lexon ke sevape dhe çdo sevap është i barabartë me dhjetë të tilla. Kështu pra – Allahu të bekoftë –, sa herë që lexon të shtohet shpërblimi, sa më shumë që ta lexosh Kur`anin të shtohet shpërblimi. Kjo është prej bereqetit në jetë, kjo është prej bereqetit në jetë, andaj mos e privo veten tënde nga mirësia. Ama, nëse ke mundësi që ta lexosh akoma më shumë Kur`anin (atëherë bëje)! Dhe sa nxënësia të dijes lexojnë ndoshta në një ditë të vetme dhjetë xhuze! Suksesi është prej Allahut - *'Azze ue Xhel-le -* dhe mirësia është në Dorën e Allahut - *Tebarake ue Te'ala -*.

Po kështu, si je ti me dhikrin e Allahut - *'Azze ue Xhel-le -*, me tesbihin (të thuash *SubhanAllah*), me tahmidin (të thuash *Elhamdulillah*), me tahlilin (të thuash *La ilahe ilAllah*) dhe istigfarin (të thuash *Estagfirullah*)?

Si je ti me bamirësinë ndaj prindërve? Si je ti me mbajtjen e lidhjeve me farefisin? A sillesh mirë me prindërit? A i mban lidhjet me farefisin?



Të gjitha këto pra, janë prej përgatitjes për Takimin me Allahun - Tebarake ue Te’ala -. Si je ti me të gjitha këto? Shiko çfarë je duke bërë e çfarë je duke vepruar. I suksesshëm është ai të cilit i jep sukses Allahu - ‘Azze ue Xhel-le -. I suksesshëm është ai të cilit i jep sukses Allahu - ‘Azze ue Xhel-le -.

Po kështu - Allahu të ruajt -, si je ti me bamirësinë ndaj fqinjëve të tu, si je ti me mbajtjen e lidhjeve farefisnore, si je ti me thënien e të vërtetës, me kryerjen e amanetit dhe mbajtjen e premtimit? Si je ti me problemin e përgojimit dhe thashethemeve? A je ti larg prej tyre? Si je ti në raport me ata njerëz që kanë urrejtje, kanë ligësi, kanë smirë dhe qëllime të këqija për vëllëzërit e tu Muslimanë? A je ti prej atyre që janë në gjendje të mirë tek ky aspekt apo je prej atyre që neglizhojnë? Foli vetes tënde, merre vesh në ç’gjendje je dhe shiko çfarë po bën, sepse i suksesshëm është ai i cili i bën llogarinë vetes së vet vazhdimisht.

Po kështu - Allahu të bekoftë -, si je ti me fitimin e pasurisë dhe me shpenzimin e saj? A po e nxjerr pasurinë me atë rrugë që e ka lejuar Allahu dhe a po e shpenzon pasurinë tënde aty ku e ka lejuar Allahu? E nëse gjen se po e fiton pasurinë me haram, atëherë rishikoje veten tënde dhe pendohu tek Allahu, dhe mjaftohu me atë që ta ka lejuar Allahu, edhe nëse ajo është e paktë; e nëse e shpenzon pasurinë, e shpenzon në atë që e ka ndaluar Allahu, atëherë rishikoje veten tënde dhe pendohu tek Allahu dhe shpenzoje aty ku ta ka lejuar Allahu - Xhel-le ue ‘Alaa -.

Kështu pra - Allahu të bekoftë -, duhet të jesh në të gjitha punët e tua, përmbaju Librit të Allahut dhe Sunetit të të Dërguarit të Allahut - sal-lAllahu ‘alejhi ue ‘ala Aalihi ue sel-lem -, sepse Pejgamberi - sal-lAllahu ‘alejhi ue ‘ala Aalihi ue sel-lem - thotë:

إِنَّ الْحَلَالَ بَيْنَ وِ إِنَّ الْحَرَامَ بَيْنٌ، وَ بَيْنَهُمَا أُمُورٌ مُشْتَبِهَاتٌ لَا يَعْلَمُوهُنَّ كَثِيرٌ مِنَ النَّاسِ.

“O ju që besoni kijeni frikë Allahun dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përçatitur për të nesërmen!”
Liqjërati e mbajtur nga Shejkh ‘Abdul-‘Aziiz Dbën Jahja el-Bura’ij në Radio,Selefi.org



“Hallalli është i qartë dhe harami është i qartë. Midis tyre ka gjëra të dyshimta që shumë njerëz nuk i njohin.”¹³

Kështu pra, hallalli është i qartë përpara njerëzve dhe harami është i qartë. Porse ka disa çështje në të cilat ngatërrohen disa njerëz, prandaj njeriu duhet të tregohet i kujdesshëm në ato çështje. Kush është ai që nuk e di se pijet dehëse janë haram? Kush është ai që nuk e di se zinaja është haram? Kush është ai që nuk e di se kamata është haram? Kush është ai që nuk e di se mosbindja ndaj prindërve është haram, se shkëputja e lidhjeve farefisnore është haram, se sjellja e keqe me fqiu është haram? Kush nuk e di obligueshmërinë e faljes së namazit? Kush nuk e di mirësinë e recitimit të Kur`anit? Kush nuk e di mirësinë e Haxhit? Kush nuk i di mirësitë e ibadeteve të tjera?

Pra, i Dërguari - *sal-lAllahu ‘alejhi ue ‘ala Aalihi ue sellem* - tha: “Hallalli është i qartë dhe harami është i qartë.” Prandaj, muslimani i logjikshëm duhet të përgatitet për Takimin me Allahun - *‘Azze ue Xhel-le* -. E më pas, Allahu e ripërsërit urdhërin për devotshmëri kur thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَلْتَنْظُرْ نَفْسٌ مَّا قَدَّمَتْ لِغَدٍ وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ

“O ju që besoni, kijeni frikë Allahun dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përçatitur për të nesërmen. Dhe kijeni frikë Allahun, se me të vërtetë Allahu është i Mirëinformuar për ato që bëni ju.”¹⁴

Dhe kjo të tregon se ti ke nevojë për *tekua* (frikë) ndaj Allahut, në fillim e në fund. Përpara se të sjellësh ndërmend çfarë ke përçatitur për nesër, kije frikë Allahun. Edhe pasi që e sjell ndërmend çfarë ke përçatitur për nesër, ti ke nevojë për *tekua* ndaj Allahut, ngase Allahu - *‘Azze ue Xhel-le* - i thotë Pejgamberit të Tij:

¹³ E ka transmetuar Bukhari (nr.52, 2051) dhe Muslimi (nr.1599).

¹⁴ El-Hashr, 18.

“O ju që besoni kijeni frikë Allahun dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përçatitur për të nesërmen!”
Ligjëratë e mbajtur nga Shejkh ‘Abdul-‘Aziiz Dbën Jahja el-Bura’ij në Radio,Selefi.org



يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ اتَّقِ اللَّهَ

“O ti Pejgamber, kije frikë Allahun...”¹⁵

Ndonëse Pejgamberi - *sallAllahu ‘alejhi ue ‘ala Aalihi ue sellem* – thotë:

“Unë jam më i devotshmi prej jush tek Allahu dhe ai që i frikësohet më shumë Atij.”

Dhe thotë Allahu - ‘Azze ue Xhel-le -:

“O ju që besoni, frikësojuni Allahut.” Pra, i urdhëroi besimtarët për *tekua* (frikë ndaj Allahut).

Dhe thotë:

قُلْ يَاعِبَادِ الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا رَبَّكُمْ

“Thuaju robërve të mi që besuan: Kijeni frikë Zotin tuaj!”¹⁶

Pra, i urdhëroi besimtarët për *tekua* (frikë ndaj Allahut).

Ne jemi të urdhëruar që t’i frikësohemi Allahut - *Subhanehu ue Te’ala* - në çdo gjendje, në çdo kohë dhe jemi përgjegjës përpara Allahut - ‘Azze ue Xhel-le - për këtë adhurim kaq madhështor, që është *et-tekua* (devotshmëria). Dhe siç e dëgjuat, ajo që kihet për qëllim me devotshmëri është: veprim me bindje (ndaj urdhërave të Allahut dhe të Dërguarit të Tij) dhe lënia e mosbindjes, si dhe punimi me Sunetin dhe braktisja e Bidatit. E gjithë kjo është prej devotshmërisë ndaj Allahut - *Tebarake ue Te’ala* -. Dhe i ka porositur Allahu - ‘Azze ue Xhel-le - popujt përpara nesh me devotshmëri ndaj Tij.

¹⁵ El-Ahzab, 1.

¹⁶ Ez-Zumer, 10.

“O ju që besoni kijeni frikë Allahun dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përçatitur për të nesërmen!”
Liqjërati e mbajtur nga Shejkh ‘Abdul-‘Aziqz Dben Jahja el-Bura’ij në Radio.Selefi.org



وَلِلَّهِ مَا فِي السَّمٰوٰتِ وَمَا فِي الْاَرْضِ ۗ وَلَقَدْ وَصَّيْنَا الَّذِيْنَ اٰتٰوْا الْكِتٰبَ مِنْ قَبْلِكُمْ وَاِيَّاكُمْ
اَنْ اَتَّقُوْا اللّٰهَ

“E Allahut është gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Ne i kemi porositur ata që u është shpallur Libri para jush dhe juve: “Frikësojuni Allahut!”¹⁷

Dhe Ai ka thënë: “O ju njerëz, frikësojuni Zotit tuaj.” Pra, Ai i urdhëroi të gjithë njerëzit që të kenë frikë Allahun - *Subhanehu ue Te’ala* -.

Pastaj, Ai tha: “Frikësojuni Allahut, Ai është i Gjithëinformuari për ato që veproni.” Pra, Ai e di çfarë veprojmë dhe është i Gjithëinformuar për gjendjen tonë. Atij nuk i fshihen as punët tona, as fjalët tona e as ato që fshehin zemrat tona. Atij nuk i fshihet asnjë e fshehtë dhe sekreti është i ditur tek Ai. Kështu që, kije në mendje Zotin tënd, i Cili të mbikqyr.

اِنَّ اللّٰهَ كَانَ عَلَيكُمْ رَقِيْبًا

“Vërtet Allahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju.”¹⁸

Dhe ka thënë Allahu - *‘Azze ue Xhel-le* -:

وَمَا تَكُوْنُ فِيْ شَأْنٍ وَمَا تَتْلُوْا مِنْهُ مِنْ قُرْءٰنٍ وَلَا تَعْمَلُوْنَ مِنْ عَمَلٍ اِلَّا كُنَّا عَلَيْكُمْ شٰهُدًا اِذْ
تُفِيضُوْنَ فِيْهِ ۗ وَمَا يَعْزُبُ عَنْ رَبِّكَ مِنْ مِّثْقَالِ ذَرَّةٍ فِى الْاَرْضِ وَلَا فِى السَّمٰوٰتِ وَلَا اَصْغَرَ مِنْ
ذٰلِكَ وَلَا اَكْبَرَ اِلَّا فِى كِتٰبٍ مُّبِيْنٍ

¹⁷ En-Nisaa`, 131.

¹⁸ En-Nisaa`, 1.

“O ju që besoni kijeni frikë Allahun dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përçatitur për të nesërmen!”
Liqjërati e mbajtur nga Shejkh ‘Abdul-‘Aziqz Dben Jahja el-Bura’ij në Radio,Selefi.org



“Në çfarëdo pune që të jesh, çfarëdo që të lexosh nga Kurani dhe çfarëdo pune që të bëni (o njerëz), Ne jemi dëshmitarë, kur ju të thelloheni në të. Zotit tënd nuk i fshihet asnjë grimë peshe, në Tokë e në qiell; as më pak nga ajo e as më shumë nuk mbetet pa u shënuar në Librin e qartë.”¹⁹

Dhe Ai ka thënë:

وَعِنْدَهُ مَفَاتِحُ الْغَيْبِ لَا يَعْلَمُهَا إِلَّا هُوَ وَيَعْلَمُ مَا فِي الْبَرِّ وَالْبَحْرِ وَمَا تَسْقُطُ مِنْ وَرَقَةٍ إِلَّا

يَعْلَمُهَا وَلَا حَبَّةٍ فِي ظُلْمَتِ الْأَرْضِ وَلَا رَطْبٍ وَلَا يَابِسٍ إِلَّا فِي كِتَابٍ مُبِينٍ ﴿٥١﴾

“Ai i ka çelësat e së padukshmes dhe vetëm Ai i njeh ato. Ai e di ç’ka në tokë dhe në det; asnjë gjeth nuk bie, pa e ditur Ai dhe nuk ekziston asnjë kokërr në errësirën e tokës, as e njomë, as e thatë, që të mos jetë shënuar në Librin e qartë (Leuhi Mahfudh).”²⁰

Prandaj, ne i kërkojmë Allahut ndihmën e Tij, i kërkojmë Allahut suksesin dhe saktësinë.

Pastaj thotë Allahu - ‘Azze ue Xhel-le - duke tërhequr vëmendjen:

“E mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten! Pikërisht ata janë të pabindurit (ndaj Allahut).”²¹

Po! Ai thotë: Ju jeni të urdhëruar! Shikoni çfarë keni përçatitur për nesër, dhe mos u bëni si ata të shkujdesurit, të cilët u sollën me Allahun sikur e kishin harruar Atë. Ata e harruan Allahun. Në të vërtetë ata nuk e harruan Allahun, në kuptimin që u kishte dalë nga mendja, sepse ata e

¹⁹ Junus, 61.

²⁰ El-En’am, 59.

²¹ El-Hashr, 19.



dëgjojnë ezanin dhe ikametin, dhe i dëgjojnë njerëzit duke recituar Kur`anin etj., mirëpo ata u sollën me Allahun sikur e kishin harruar Atë. Kështu, Ai i bëri ata që t’i harronin vetet e tyre. Ata nuk i harruan vetet e tyre nga ushqimi, nga pija, nga veshmbathja, nga martesja, nga kafshët dhe mjetet e udhëtimit, nga shtëpitë e banimit etj., mirëpo ata i lanë pas dore vetet e tyre, duke mos i hequr të këqijat që mbanin përbrenda veteve të tyre dhe të fushin në to mirësinë. Pra, ata u treguan harraqë ndaj veteve të tyre. Dhe ashtu siç e harruan Allahun, Allahu i dënoi ata duke i bërë që t’i harronin vetet e tyre. Dhe shpërblimi është sipas llojit të punës.

وَلَا تَكُونُوا كَالَّذِينَ نَسُوا اللَّهَ فَأَنْسَاهُمْ أَنْفُسَهُمْ أُولَٰئِكَ هُمُ الْفَاسِقُونَ ﴿١٩﴾

“E mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten! Pikërisht ata janë të pabindurit (ndaj Allahut).”²²

Allahu i shpalli ata të pabindur, për shkak se ata nuk u përgatitën për Takimin me Allahun - ‘Azze ue Xhelle -, se atyre iu shtuan gjynahet dhe mosbindja, iu shtuan kundërshtimet, e harruan Allahun - ‘Azze ue Xhelle -, i kthyen shpinën Sheriatit të Tij, i kthyen shpinën Udhëzimit të Tij dhe e braktisën devotshmërinë për Të. Kështu, ata i dënoi Allahu - ‘Azze ue Xhelle - duke i bërë që t’i harrojnë vetet e tyre, dhe i dënoi Allahu - ‘Azze ue Xhelle - duke i bërë prej të pabindurve.

Pastaj, tha Allahu - Subhanehu ue Te’ala -:

لَا يَسْتَوِي أَصْحَابُ النَّارِ وَأَصْحَابُ الْجَنَّةِ أَصْحَابُ الْجَنَّةِ هُمُ الْفَائِزُونَ ﴿٢٠﴾

“Nuk janë të barabartë banorët e Zjarrit dhe banorët e Xhenetit; banorët e Xhenetit do të jenë të fituarit.”²³

²² El-Hashr, 19.

²³ El-Hashr, 20.

“O ju që besoni kijeni frikë Allahun dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përçatitur për të nesërmen!”
Ligjëratë e mbajtur nga Shejkh 'Abdul-'Aziqz Dben Jahja el-Bura'ij në Radio,Selefi.org



Domethënë që besimtarët të cilët iu frikësuan Allahut dhe menduan çfarë do të përgatisnin për të nesërmen, nuk janë si ata të cilët e harruan Allahun dhe Ai i bëri që t'i harronin vetet e tyre. Pra, besimtarët që u përgatitën për Takimin me Allahun dhe menduan çfarë do të përgatisnin për të nesërmen, ata janë banorët e Xhenetit. Kurse ata të cilët e harruan Allahun dhe Ai i bëri që t'i harrojnë vetet e tyre, ata janë të pabindurit dhe ata janë banorët e Zjarrit.

لَا يَسْتَوِي أَصْحَابُ النَّارِ وَأَصْحَابُ الْجَنَّةِ أَصْحَابُ الْجَنَّةِ هُمُ الْفَائِزُونَ ﴿٢٤﴾

“Nuk janë të barabartë banorët e Zjarrit dhe banorët e Xhenetit; banorët e Xhenetit do të jenë të fituarit.”²⁴

Domethënë, nëse e mësove këtë, atëherë ti je ai që e ndihmon veten tënde, sepse ti e di shumë mirë që ai i cili është në Xhenet është më i mirë se ai që është në Zjarr, sikurse ka thënë Allahu - *Subhanehu ue Te'ala* -:

وَقُلِ الْحَقُّ مِنْ رَبِّكُمْ ۖ فَمَنْ شَاءَ فَلْيُؤْمِنْ وَمَنْ شَاءَ فَلْيُكْفُرْ ۚ إِنَّا أَعْتَدْنَا لِلظَّالِمِينَ نَارًا أَحَاطَ بِهِمْ سُرَادِقُهَا ۚ وَإِنْ يَسْتَغِيثُوا يُغَاثُوا بِمَاءٍ كَالْمُهْلِ يَشْوِي الْوُجُوهَ ۚ بِئْسَ الشَّرَابُ وَسَاءَتْ مُرْتَفَقًا

﴿٢٥﴾ إِنَّ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ إِنَّا لَا نُضِيعُ أَجْرَ مَنْ أَحْسَنَ عَمَلًا ﴿٢٥﴾

“Dhe thuaj: “E vërteta është nga Zoti juaj. Andaj, kush të dojë, le të besojë e kush të dojë, le të mohojë” Ne kemi përgatitur për mohuesit zullumqarë një zjarr, që do t'i rrethojë nga të gjitha anët. Nëse do të kërkojnë ndihmë, do t'u jepet një ujë si xehja e shkrirë, që do t'ua përcëllojë fytyrat. Sa pije e tmerrshme është ajo e sa strehim i keq është ai (zjarri)! Sa për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, sigurisht që Ne nuk do t'ua humbim shpërblimin punëmireve.”²⁵

²⁴ El-Hashr, 20.

²⁵ El-Kehf, 29-30.

“O ju që besoni kijeni frikë Allahun dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përçatitur për të nesërmen!”
Liqjërati e mbajtur nga Shejkh ‘Abdul-‘Aziqz Dben Jahja el-Bura’ij në Radio,Selefi.org



E gjer në fund të këtyre ajeteve.

Pra, Ai përmendi se përfundimi i mosbesimtarëve do të jetë Zjarri, kurse përfundimi i besimtarëve do të jetë Xheneti.

Dhe tha Allahu - *Subhanehu ue Te’ala* -:

إِنَّ الَّذِينَ يُلْحِدُونَ فِي آيَاتِنَا لَا يَخْفَوْنَ عَلَيْنَا أَفَمَنْ يُلْقَى فِي النَّارِ خَيْرًا مِّنْ يَأْتِيءَ آمِنًا يَوْمَ الْقِيَامَةِ

“Ata që i shtrembërojnë shpalljet Tona, nuk mund të Na fshihen. Si mendoni, a është më i mirë ai që do të hidhet në Zjarr apo ai që në Ditën e Kiametit do të vijë i sigurt?”²⁶

Pra, kjo është e qartë. Pastaj Ai tha:

أَعْمَلُوا مَا شِئْتُمْ إِنَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ

“Bëni ç’të doni, se Ai i sheh të gjitha çfarë punoni ju.”²⁷

Dhe Ai ka thënë:

إِنَّا هَدَيْنَاهُ السَّبِيلَ إِمَّا شَاكِرًا وَإِمَّا كَفُورًا

“Vërtet, Ne i treguam atij rrugën e drejtë, që ai të jetë ose mirënjohës, ose mosmirënjohës.”²⁸

Dhe Ai ka thënë:

²⁶ Fussilet, 40.

²⁷ Fussilet, 40.

²⁸ El-Insan, 3.

“O ju që besoni kijeni frikë Allahun dhe le të shohë çdo njeri çfarë ka përçatitur për të nesërmen!”
Liqjërati e mbajtur nga Shejkh ‘Abdul-‘Aziq Obën Jahja el-Bura’ij në Radio,Selefi.org



وَهَدَيْنَاهُ النَّجْدَيْنِ

“Ne ia kemi bërë të qarta të dyja rrugët.”²⁹

Pra, Allahu ta ka bërë të qartë ty Rrugën dhe ta ka sqaruar *Hakun* (të vërtetën) nga *Batili* (e pavërteta), kështu që, s’ të mbetet gjë tjetër veçse të përpiqesh për të mirën dhe të jesh besnik me Allahun.

Allahu na bëftë neve dhe juve prej robërve të Tij besnikë.

Dhe të gjitha lavdet janë për Zotin e gjithësisë.

*Përkthen: Alban Malaj
E Xhuma, 14 Xhumadel-Enel 1435 Hixhriq/14 Mars 2014 Miladiq
‘Anali, Mekkeh*

²⁹ El-Beled, 10.